

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 235 REP.
NR. 78 KOL.

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" CONINVEST" SH.P.K



Sot më datë 21.11.2018 (dymijë e tësëmbëdhjetë), përpara meje Noteres Eva Blushi, me zyrë në Tirane u paraqitën personalisht shtetasit e mëposhtëm:

1. **Z. Denion Idrizi**, i biri i Shpetimit, lindur me 07.08.1992, në Tirane, dhe banues në, Tirane madhor me zotësi të plote për të vepruar, identifikuar me Pasaportën me nr. BC1003117 dhe nr.personal. J20807057A.
2. **Z. Arjan Çukaj**, i biri i Qerimit, lindur me 11/06/1969, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, mbajtes i pasaportës me nr. BE6198117 dhe nr. personal G90611106E, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Te cilet me cilesine e themeluesve me kerkuan redaktimin e ketij akt themelimi, nepermjet te cilit ata deklarojne se me vullnet të lire e të plote dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne Ligjin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, " CONINVEST" SH.P.K.

KREU 1

**Neni 1
Krijimi**

Shoqeria "CONINVEST" SH.P.K, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2
Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "CONINVEST " SH.P.K, është një shoqëri, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia

Selia e Shoqërisë është në Rr Brigada e VIII, Vila Metropolitan, Bllok, Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë edhe zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë :

Objekti i veprimtarisë të kësaj shoqërie është: "Aktivitete në fushën e ndërtimit, ndërtim objekte civile publike rrugë etj- Njëje betoni, prodhim inertesh. Nxjerrje, perpunim, import eksport të mineraleve të ndryshme. Tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore, industriale, elektrike etj Projektim godina civile industriale ekonomike bujqësore etj Hartimi i projekteve për Hec dhe të impjanteve hidrike. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin energjisë elektrike dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë. Furnizimi i shërbimeve me asistencë teknike, mirëmbajtje dhe riparim të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, duke përfshirë asistencën teknike, mirëmbajtjen dhe riparimin e çdo lloji ndërtimesi. Kërkimi dhe zhvillimi i sistemeve për repermisuar proarran, trajnime profesionale dhe për menaxhim, në favor të personelit dhe të bashkëpunetoreve në interes të nevojave të shoqërisë. Import - eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë të mallrave, materialeve dhe aparaturave të ndryshme. Konsulencë teknike, administrative, menaxhuese dhe të çdo natyre tjetër që ka lidhje me objektin e shoqërisë. Import eksport dhe Tregtim me shumicë dhe pakicë të lendeve drusore Për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si edhe të blejë dhe shesë ose manë me qira ndërmarrje, dege ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelime të siper, që kanë objekt të njëjtit ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Me në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë. Të ushtrojë aktivitet privat në fushën e shërbimeve kryesisht projektimi, ndërtimi dhe operimi i H.E.C-ve, ku përfshihet ndërtimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislativin në fuqi."

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitalithemeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte _100.000_ lekë.

- me 100% te kuotave, me vlere _100.000_ Leke,

Kapitali eshte i ndare ne 2 kuota me vlere (50.000 Lekë) leke secila .

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet sipas formave te parashikuara nga ligji.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve, deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10 Administrimi

3. Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 5 (pese) vjetore, emërohet **Z. Arjan Çukaj**, i biri i Qerimit, lindur më 11/06/1969, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, mbajtes i pasaportes me nr. BE6198117 dhe nr. personal G90611106E, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta

injononin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakeve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jehet :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare "
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër " .

Neni 14 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15 Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij

statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "CONINVEST" sh.p.k, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të cilave vertetohet nga une Noteri.Unë, Noteri, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të nenit 54 e vijues të Kodit Civil dhe Ligjit Nr.7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

ORTAKET

1. Z.Denion IDRIZI

DENION IDRIZI

2. Z.Arjan CUKAJ

Arjan Cukaj

[Signature]

*Notere
Ena Blushi*

[Signature]